



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 3 Prot.Vlorë më, 23 . 01 . 2017

**V E N D I M**

Nr. 24, datë 10 . 01. 2017

**P ë r**

**Miratimin e Programeve të Studimit 5-vjeçar në fushën e Drejtësisë, si dhe përcaktimin e kriterëve shtesë për efekt rankimi, për pranimin në programet e studimit, në Kolegjin Universitar "Pavarësia" Vlorë, për vitin akademik 2017 - 2018**

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma "d", dhe 82 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"; si dhe në nenin 9, pika 1, gërma "dh" dhe "g" të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit;

Si dhe në përgjigje të shkresës së ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nr. 12333 Prot, datë 09.12.2016, "Mbi përcjelljen e kriterëve të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit me karakter profesional, si dhe programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2017-2018";

Senati Akademik i Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë",

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e propozimit të Dekaniatit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, për miratimin e Programit të Studimit 5 vjeçar në fushën e Drejtësisë, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij Vendimi.
2. Krahas kriterëve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, **për efekt rankimi**, miratimin e kriterëve shtesë të pranimit në programet e studimit (Bachelor) në degët: Ekonomi, Shkenca politike, Inxhinieri informatike, si dhe në programet e ciklit 5 vjeçar në Arkitekturë, dhe 5 vjeçar në Drejtësi, për vitin akademik 2017 - 2018, si më poshtë:
  - a. Mesatare e shkollës së mesme, 70 %;
  - b. Mesatare e grup-lëndëve, 30 %;
  - c. Për shkollat profesionale shtohet edhe kriteri prej 15 %, i diferencuar sipas profilizimit të programeve.



3. Kriteret e parashikuara në pikën 2 të këtij Vendimi i referohen rankimit të aplikantëve për studentë, të cilët kanë mesataren e shkollës së mesme të barabartë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Prof. As. Dr. Luan GJONÇAJ**

